



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P.nr.2500/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI I PËRGJITSHËM, DIVIZIONI PENAL, sipas gjyqtarës Lumnije Krasniqi, me procesmbajtësen Ganimete Krasniqi, në lëndën penale kundër të pandehurit F.J. për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1, lidhur me par.6 të KPRK-së (Ligji nr.06/L-074), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2212/2017 dt.03.05.2017, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 27.10.2020, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rexhep Maqedonci dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 12.11.2020 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

F. J., i biri i R. dhe e ëma Xh., e vajzërisë M., i lindur me datë, në P., me vendbanim me qira në rr.”...”” hyrja, Prishtinë, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, baba i dy fëmijëve, gjendjes së dobët ekonomike, invalid i luftës, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. të letërnjoftimit

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

Me datën 02.03.2017 punëtorët e autorizuar të KEDS-it, gjatë kontrollit te konsumatori me numër DPR 527, kanë konstatuar se i pandehuri, me qëllim që vetit t'i sjellë pasuri të kundërligjshme, është furnizuar me energji elektrike, ku ka hequr hyrje-daljet nga njehsori dhe ka bërë lidhjen-hyrje daljen para pikës matëse, përmes një kleme, ku energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare, me ç ‘rast të dëmtuarës KEDS-it i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 956,22 euro,

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1, lidhur me par.6 të KPRK-së.

Prandaj, kjo Gjykatë, në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 40, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, dhe nenit 245, 359, 361, 365, 366, 453 dhe 463 të KPPRK-së, të pandehurin e:

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 100 (njëqind) euro, të cilin obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dy këste mujore.

Nëse personi i dënuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, Gjykata do t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim, me njëzet (20) Euro të gjobës.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike.

E dëmtuara KEDS, në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.2212/2017 dt.03.05.2017, e ka akuzuar pandehurin F.J.për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve Lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata me datën 27.10.2020 mbajti seancën publike të shqyrtimit fillestar, në të cilën kanë prezantuar Prokurori i Shtetit Rexhep Maqedonci dhe i pandehuri, në të cilën Prokurori i Shtetit fillimisht bëri ri cilësimin e veprës penale, ashtu që nga vepra penale Lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 të KPRK-së, e ri cilësoi në veprën penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1, lidhur me par.6 të KPRK-së, duke aplikuar Kodin e Ri Penal, Ligji nr.06/L-074, si ligj më të favorshëm për të pandehurin, më pas e lexoi aktakuzën dhe menjëherë të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm dhe i pandehuri në shqyrtimin fillestar, deklaroi se e ka kuptuar aktakuzën në tërësi, me vullnet të plotë, dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, duke theksuar se i vjen keq për atë që ka ndodh dhe ka premtuar se më nuk do të përsëris veprime të tilla.

Prokurori i shtetit, lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë, sepse pranimi i fajësisë është në përputhje të plotë me dispozitën ligjore nga neni 248 të KPPK-së, dhe i bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e në të cilat është mbështetur aktakuza.

Me që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi për kryerjen e veprës penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi paraprakisht e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të kryerjes së veprës penale, pranimi i cili është bërë vullnetarisht, pranimi i cili mbështetet në faktet e çështjes dhe provat që përmban aktakuza, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabim faktik.

Gjykata vlerësoi se janë përmbushur të gjitha kërkesat ligjore nga neni 248 të KPPK-së, që të pranohet deklarata e të akuzuarit për pranimin e fajësisë për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe të njëjtën edhe e ka aprovuar, ashtu që nuk ka administruar asnjë provë për të vërtetuar gjendjen faktike.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin fillestar u vërtetuar se ai me datë, kohë dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij, ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë procesverbali nr.2155446 dt.02.03.2017, fatura nr.DPR17HP2126 , dt.03.03.2017, foto dokumentacioni si dhe shkresat e tjera të lëndës, gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit F.J.formësohen të gjitha elementet qenësore objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.1, lidhur me par.6 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, pasi që gjeti se penalisht është i përgjegjshëm dhe e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit, gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në bazë të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, në rastin konkret gjykata mori parasysh minimumin dhe maksimumin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale dhe vlerësoi se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, si rrethana lehtësuese gjeti se: i pandehuri e pranoi fajësinë në shqyrtimin fillestar, se më parë nuk është dënuar, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti. Andaj i shqiptoi dënimin sikur në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se dënimi i tillë do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e kryesit, si dhe do të ndikojë tek të tjerët të mos kryejnë vepra penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 par.4 të KPPRK-së, ku gjykata e ka liruar të pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale për shkak se është invalid i luftës dhe gjykatës ia ka prezantuar librezën me nr.2775.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPRK-së.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në pajtim me dispozitat ligjore nga neni 365 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.2500/17 dt.12.11.2020

Procesmbajtësja
Ganimete Krasniqi

Gjyqtarja
Lumnije Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.